



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme – Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

**Raporti për Zbatimin e Strategjisë Nacionale për Siguri në Bashkësi
dhe Planin e Veprimit për vitin 2022.**

**Prishtinë,
Shkurt 2023**

1 PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) përmes Strategjisë Nacionale për Siguri në Bashkësi (në vazhdim SNSB) do të kontribuojë në krijimin e një ambienti të sigurt në bashkësi për të gjithë duke bashkëpunuar me komunitetin në gjetjen e zgjidhjeve lokale me qëllim të rritjes së sigurisë dhe adresimit të sfidave tek institucionet përkatëse. Hartimi i raportit për vitin 2022 për zbatimin e SNSB-së dhe Plani i Veprimit 2018-2023 është përgatitur me ndihmën e Ekipit për mbikëqyrjen e Zbatimit të SNSB¹-së.

Implementimi i SNSB-së ka ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës pa dallim. Ky dokument strategjik ka për qëllim, që të fuqizojë përpjekjet institucionale në nivel qendror dhe lokal dhe akterëve të tjerë në parandalimin e dukurive negative që cenojnë lirin e lëvizjes së qytetarëve në përgjithësi.

Përmes këtij raporti synojmë të ofrojmë informata të nevojshme për institucionet përgjegjëse vendore dhe ndërkombëtare, si dhe palët e tjera të interesuara për të arriturat, sfidat gjatë zbatimit të aktiviteteve të parapara në planin e punës.

Gjatë vitit 2022 janë mbajtur 2 takime të Ekipit mbikëqyrës për zbatim të SNSB-së dhe planit të veprimit, vlerësimi i implementimit është bërë për 5 objektivat strategjike dhe 40 aktivitete për periudhën kohore janar-dhjetor 2022. Vlen të theksohet se kanë raportuar vetëm 7 anëtarë të Ekipit mbikëqyrës për zbatim të SNSB-së në lidhje me aktivitetet e zhvilluar për vitin 2022.

Nga implementimi i aktiviteteve të parapara për secilin objektiv strategjik të kësaj Strategjie mund të konkludojmë se ka pasur një ndikim pozitiv në disa prej tyre. Ndërsa mungesa e progresit për disa aktivitete të parapara në planin e veprimit është e evidente.

2 PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE

Nga përmbledhja e raporteve nga anëtarët e Ekipit mbikëqyrës për zbatimin e SNSB-së, mund të kolojdojmë së është arritur një ndikim pozitiv.

Gjatë vitit 2022 janë themeluar shumica e KKSB-ve në të cilin janë të përfshirë të gjitha komunitetet jo-shumicë dhe duke marrë për bazë edhe kriterin gjinor në KKSB-të, duke ju garantuar pjesëmarrje aktive gjatë takimeve të KKSB-së, në bazë të raporteve janë mbajtur 111 takime të KKSB-së si dhe duke adresuar të gjitha shqetësimet e sigurisë në bashkësi. Një rol të rëndësishëm në implementimin e shumë aktiviteteve kanë pasur forumet lokale të sigurisë në bashkësi në identifikimin dhe adresimin e tyre për parandalim.

Ministria e Punëve të Brendshme në vazhdimësi gjatë festave të fund vitit organizon fushata vetëdijësuese për parandalimin e gjuajtjeve me armë të

¹ Vendimi për Ekipin për Mbikëqyrjen e Zbatimit të SNSB me Nr. 105/2022, datë 01.02.2022

zjarrit dhe përdorim të sigurt të mjeteve piroteknike dhe fishekjarrëve me moto "Festo me Zemër jo me armë", lidhur me vetëdijesimin e bashkësisë mbi çështjet e trafikimit me qenie njerëzore, parandalimin e dhunës në familje, një rol të rëndësishëm kanë pasur edhe forumet lokale të sigurisë në bashkësi në mbështetje të nivelit qendror konkretisht të MPB-së duke mos i përjashtuar edhe institucionet tjera.

2.1 PROGRES KUNDREJT OBJEKTIVIT:

Objektivi Strategjik 1. Fuqizimi i kapaciteteve të mekanizmave të sigurisë që merren me parandalim të dukurive negative me qëllim të uljes së nivelit të krimit dhe problemeve në siguri në bashkësi.

Në kuadër të këtij objektivi janë të parapara 12 aktivitetet, ne vazhdim po i paraqesim shkurtimisht të arriturat për secilin aktivitet gjatë implementimit për vitin 2022:

- Gjatë vitit 2022 nga DSB-ja është hartuar raporti për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi dhe Policimit në Bashkësi;
- Pas përfundimit të zgjedhjeve të rregullta lokale, në shumica e komunave gjatë viti 2022 i kanë themeluar Këshillat Komuna për Siguri në Bashkësi. Ndërsa nuk janë themeluar KKSB-të në këto komuna: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq, Zveqan dhe Novobërdë;
- Gjatë vitit 2022 janë rivitalizuar 3 KLSP në: Mitrovicë jugore, Mitrovicë veriore dhe Prishtinë, si dhe janë mbajtur 2 trajnime për këto 3 KLSP të themeluara, kurse nuk ka pasur të themeluar dhe të ri-vitaliuar EVSB;
- Janë mbajtur trajnimin e mekanizmave/forumeve të sigurisë në bashkësi, si dhe janë certifikuar 19 trajnerë për KLSP-të nga OSBE-ja;
- Nuk është realizuar asnjë ligjëratë për kadetët policor rreth forumeve të sigurisë në bashkësi.

Objektivi Strategjik 2. Përfshirja e vazhdueshme e komuniteteve në mekanizmat e sigurisë në bashkësi

Në kuadër të këtij objektivi janë të parapara 6 aktivitetet, vazhdim po i paraqesim shkurtimisht të arriturat për secilin aktivitet gjatë implementimit për vitin 2022:

- Është vazhduar me realizimin e takimeve me anëtarët e komunitetit për pjesëmarrje aktive në forumet e sigurisë në bashkësi. Më datë 26.08.2022, është realizuar një takim me anëtarët e KKSB-së në komunën e Kamenicës dhe përfaqësuesit e komunitetit pakicë të cilët nuk janë anëtarë të KKSB-së, i pranishëm ishte Zv. Ministri i MPB, Blerim Gashani,. Duke ju bërë thirrje për bashkëpunim me institucionet e sigurisë dhe pjesëmarrje aktive në takimet e forumeve të sigurisë, ndërsa janë mbajtura 167 takime me KLSP ku anëtarë të tyre vijnë nga gjitha komunitetet;
- Disa nga shqetësimet e sigurisë duke pasur për bazë aspektet gjinore: dhuna në

familje, ngacmimet seksuale, trafikimi me qenie njerëzore etj;

- Janë organizuar 3 kampe multi-etnike me KLSP-të Zveçan, Lagjja e Boshnjakëve, Fushë Kosovë, Gracanic, Ljubizhd, Bernicë dhe 2 Korriku mesë forumeve rinore ndër-kulturore dhe 3 aktivitete përcjellëse të këtyre forumeve ndër-kulturore me qëllim të qëndrueshmërisë së aktivitetit. OSBE organizoi shtatë aktivitete, mbështeti një aktivitet, si dhe dy kampe tenisi. Këto ngjarje kishin për qëllim nxitjen e komunikimit ndëretnik, me fokus të veçantë tek të rinjtë përmes aktiviteteve kulturore dhe sportive;
- Më datë 20.10.2022, është mbajtur tryezë e rrumbullakët me forumet e sigurisë në bashkësi në komunat e Leposaviqit dhe Zveçanit. Tema për diskutim: Trafikimi me Qenie Njerëzore, Dhuna në Familje, si dhe për forumet e sigurisë në bashkësi;
- Më datë 25.10.2022, është mbajtur tryezë e rrumbullakët me forumet e sigurisë në bashkësi në komunat e Mitrovicë e Veriut dhe Zubin Potok. Tema për diskutim: Trafikimi me Qenie Njerëzore, Dhuna në Familje, si dhe për forumet e sigurisë në bashkësi;
- Më 09.11.2022, në kuadër të takimit të KKS-së me përfaqësuesit e komunitetit në komunën e Gjilanit, është diskutuar për parandalimi e keqpërdorimit të AVL-ve dhe parandalimin e kontrabandës së tyre;
- Më 17.11.2022, në kuadër të takimit të KKS-së me përfaqësuesit e komunitetit në komunën e Hanit të Elezit, është diskutuar për parandalimi e keqpërdorimit të AVL-ve dhe parandalimin e kontrabandës së tyre;
- Në mbështetje të OSBE-së janë organizuar 3 punëtori njëditore me synim komunitetet fetare dhe anëtarët e KKS-ve për përmirësimin e sigurisë së objekteve fetare;
- Janë mbajtur 13 takime –tryeza në nivel vendi me qëllim të informimit të të gjitha komuniteteve për zbatimin e politikave pro-aktive dhe parandaluese;
- Nga ana e kabinetit të Ministrisë të MPB-së janë realizuar 5 takime me anëtarë të forumeve të sigurisë në bashkësi.

Objektivi Strategjik 3. Koordinimi ndërinstitucional në të gjitha nivelet dhe në bashkëpunim me qytetarët.

Në kuadër të këtij objektivi janë të parapara 10 aktivitete, vazhdim po i paraqesim shkurtimisht të arriturat për secilin aktivitet gjatë implementimit për vitin 2022:

- Nga ana e koordinatorëve të KKS-ve të cilat janë aktive, kemi pranuar në vazhdimësi ftesa, procesverbalet dhe raporte për aktivitete e takimeve të KKS-ve;
- Gjatë vitit 2022 nuk është mbajtur këshilli ekzekutiv i EVSB-ve;
- Nga 25 deri 27 maj 2022 është zhvilluar punëtorja treditore mbështetur nga

OSBE, për të rritur ndërgjegjësimin e KLSP-ve dhe komunitetit për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore, për 26 pjesëmarrës që përfaqësonin KLSP-të, PK-në dhe zyrtarët komunalë nga rajoni i Prishtinës;

- Është bërë “Hulumtimi i sigurisë në shkollat parauniversitare në mbarë Kosovën”. MAHTI ka bërë “Dizajnimin, implementimin dhe vlerësimin e programeve të ndryshme psiko-sociale dhe pedagogjike;
- Janë mbështetur në aspektin financiar 3 projekte të KLSP-së për siguri në bashkësi lidhur me temat: Siguri në shkolla dhe Siguri në trafik për 3 KLSP (1 KLSP-të nga Prishtina, 1 KLSP nga Gjilani dhe 1 KLSP nga Gjakova) me mbështetjen financiare e ka realizuar OSBE, si dhe janë ndarë 5 mirënjohje për KSLP-të në lidhje me aktivitetet dhe angazhimin në punën vullnetare;
- Gjatë vitit 2022 nuk është mbajtur konferencës vjetore në mes të MPB-së dhe kryesuesve të KKS-së.

Objektivi Strategjik 4. Vetëdijësimi i qytetarëve të Republikës së Kosovës për kërcënimet relevante të sigurisë në bashkësi.

Në kuadër të këtij objektivi janë të parapara 11 aktivitetet, vazhdim po i paraqesim shkurtimisht të arriturat për secilin aktivitet gjatë implementimit për vitin 2022:

- Duke u bazuar raportin mbi aktivitetet e KKS-së gjatë viteve të fundit, si dhe raportet e takimeve të rregullta të KKS-së jemi informuar në mënyrë periodike me disa nga shqetësimet me të shpeshta të sigurisë në bashkësi me të cilat përballen qytetarët, me ç'rast në vazhdim po i veçojmë disa nga dukuritë më të shpeshta si: Aksidentet në komunikacion, Vjedhjet, Vjedhjet e rënda, Dhuna në Familje, Posedimi ilegal i Armëve, Posedimi i substancave narkotike, Kontrabanda me mallra të ndryshme, Dhuna në Shkolla, infrastruktura në përgjithësi e dëmtuar, dukuria e ekstremizmit dhe radikalizmit, qenët endacak, çështjet ambientale etj;
- Planë të punës kanë pasur 22 KKS për vitin 2022;
- Platforma është krijuar dhe është bërë plotësim ndryshimi i të dhënave për KKS-të, është mbështetur nga OSBE-ja, kurse në kuadër të policisë është krijuar aplikacioni mobil “Lajmëro Policin” i aplikueshme vetëm në sistemin android ku gjatë vitit 2022;
- Kjo fushatë realizohet në vazhdimësi nga MPB-ja, janë shpërndarë fletushka, spoti në TV, në rrjetet sociale etj. Në muajin dhjetor gjatë takimeve të KKS-së diskutohet rreth parandalimi të shitjes ilegale të tyre në hapësirat publike;
- Përmes planifikimeve të ligjëratave me qëllim sensibilizimi dhe vetëdijësimi të rinjve që ka bërë DPBP, janë shpërndarë në gjitha stacionet e policisë tek policia në bashkësi të tema të ndryshme (Për parandalimin e dhunës në familje, narkotiket, bullizmi, trashëgimia kulturore, respektin ndaj shumëllojshmërisë së shoqërisë, siguria në internet, siguria në komunikacion etj), sipas raporteve për

vitin 2022 numri i ligjëratave dhe shkollave të vizituara është: 864 Shkolla, me pjesëmarrjen e 43657 nxënësve;

- Nga MASHTI është realizuar fushata e sensibilizimit për zbatimin e Protokollit 21/2013 për parandalim dhe referim të dhunës në shkolla.

Objektivi Strategjik 5. Avancimi i bazës ligjore lidhur me mekanizmat e sigurisë në bashkësi.

Në kuadër të këtij objektivi është paraparë vetëm 1 aktivitet: Themelimi i GP për vlerësimin dhe harmonizimin e zbrazëtirave ligjore si dhe nevojat e plotësimit-ndryshimit të bazës ligjore.

- Ky grup punës nuk është themeluar dhe nuk është realizuar ky aktivitet.

3. RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE

Ndërsa mungesa e disa aktiviteteve në disa fusha të parapara në Planin e Veprimit të SNSB-së, si dhe mos përmbushja e obligimeve ka ndikuar në mungesë të progresit në disa aktivitete e të cilat janë të prezantuara në vazhdim.

- Numri i vogël i takimit të ekipit mbikëqyrës për zbatim të SNSB-së dhe Planit të Veprimit 2018-2023 dhe mos pjesëmarrja e shumicës së anëtarëve gjatë dy takimeve;
- Mos raportimi në baza të rregullta i anëtarëve të ekipit mbikëqyrës për aktivitetet e realizuar gjatë vitit 2022;
- Mos mbështetja financiare për realizimin e disa aktiviteteve ku ka implikime financiare.

4. Shtojcat

Plani i Veprimit SNSB-së 2018 – 2023 (në formatin e vjetër)

Veprimi	Indikatorët e suksesit	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Afati kohor për realizim	Kostoja financiare dhe burimi i financimit €	Komentet
Objektivi Strategjik: 1. Fuqizimi i kapaciteteve të mekanizmave të sigurisë që merren me parandalim të dukurive negative me qëllim të uljes së nivelit të krimit dhe problemeve në siguri në bashkësi						
1.1. Analiza për vlerësimin e kapaciteteve të forumeve të sigurisë	Raport vlerësues i gjendjes reale të kapaciteteve të forumeve të sigurisë	MPB	MAPL, Komunat, Organizatat ndërkombëtare, Shoqëria Civile	K1 - K2	Donacion	UNDP,
1.2. Hartimi i programeve trajnuese standarde për mekanizmat e sigurisë në bashkësi	Miratimi i dokumenteve	MPB	AKSP, Organizatat ndërkombëtare e partnere	2018	Donacion,	OSBE,
1.3. Ligjërimi për kadetët policor rreth forumeve të sigurisë, me theks të veçantë për KKSBB dhe EVSB	Nr. i ligjëratave të mbajtura dhe numri i pjesëmarrësve	MPB	AKSP, PK	Në vazhdi mësi	Kosto administrative,	

1.4. Trajnimi për trajner të programit trajnues për mekanizmat e sigurisë në bashkësi	Numri i trajnerëve të certifikuar	MPB- AKSP	Organizatat ndërkombëtar e partnere	2018-2023	1.845,	Për 3 vite,
1.5. Realizimi i trajnimeve për mekanizmat e sigurisë në bashkësi	Numri i trajnimeve të realizuara	Forumet e Sigurisë, Komunat	MPB, AKSP Organizatat ndërkombëtar e dhe vendore partnere	Në vazhdi mësi	Kosto administrative,	
1.6. Trajnimi i analistëve të DSP-së për zhvillimin e raporteve analitike	Numri i analistëve të trajnuar	MPB - AKSP	Organizatat ndërkombëtar e	Në vazhdi mësi	Donacion,	UNDP,
1.7. Zhvillimi i raporteve analitike	Numri i raporteve analitike	MPB	DHS	Në vazhdi mësi	Kosto administrative,	
1.8. Themelimi dhe mbështetja e KKSB-ve në komunat: Mitrovicë veri, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan	Numri i KKSB-ve të themeluara	MPB	MAPL, PK, Komunat, Organizatat ndërkombëtar e partnere	2018-2023	Kosto administrative,	

1.9. Themelimi dhe mbështetja e EVSB-ve në komunat: Mitrovicë veri, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan	Nr. EVSB-ve të themeluara	ICITAP	MPB, MAPL, PK, Komunat Organizatat ndërkombëtar e partnere	K1-K3 2018	Donacion,	ICITAP,
1.10. Themelimi dhe mbështetja e KLSP-ve në komunat: Mitrovicë veri, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan	Nr. KLSP-ve të themeluara	PK, OSBE	MPB, Komunat Organizatat ndërkombëtar e partnere	2018-2023	Donacion,	OSBE,
1.11. Re-vitalizimi i forumeve të sigurisë.	Numri i forumeve të re-vitalizuara	MPB	MAPL, PK, Komunat, Organizatat ndërkombëtar e partnere	Në vazhdi mësi	6.000,	Për 3 vite,
1.12. Inkuadrimi i të gjithë koordinatorëve të forumeve të sigurisë në rrjetin telefonik pa pagesë	Nr. i të vendosurve në rrjet	MPB	PK	Në vazhdi mësi	8.856,	Për 3 vite,

Objektivi Strategjik: 2. Përfshirja e vazhdueshme e komuniteteve në mekanizmat e sigurisë në bashkësi;

2.1. Realizimi i takimeve me anëtarët e komunitetit për pjesëmarrjen aktive në takimet e forumeve të sigurisë	Numri i takimeve dhe numri i pjesëmarrësve	Forumet e Sigurisë	MPB, PK, MAPL, Komunat, organizatat ndërkombëtar e dhe vendore partnere	Në vazhdi mësi	3.000,	Për 3 vite,
2.2. Identifikimi i shqetësimeve të sigurisë duke marrë për bazë aspektet gjinore.	Numri i aktiviteteve të realizuara	Forumet e Sigurisë	OJQ, PK, QPS, Komunat	Në vazhdi mësi	Kosto administrative,	
2.3. Organizimi i fushatave të vetëdijesimit për mes aktiviteteve rekreative, kulturore, për përmirësimin e komunikimit ndëretnik dhe ndër fetar	Numri i fushatave për vetëdijesim	Forumet e Sigurisë	MPB, PK, MAPL, Komunat, organizatat ndërkombëtar e dhe vendore partnere	Në vazhdi mësi	Donacion,	

2.4. Organizimi i tryezave të rregullta me të gjitha komunitetet për të qenë të informuar dhe për të bërë të mundur zbatimin e politikave pro-aktive dhe parandaluese	Numri i tryezave të organizuara	Forumet e Sigurisë	MPB, PK, MAPL, Komunat, organizatat ndërkombëtar e dhe vendore partnere	Në vazhdi mësi	Komunat, Donacion,	
2.5. Takimet e forumeve të sigurisë me përfaqësues të komuniteteve	Numri i takimeve të realizuara	Forumet e Sigurisë	MPB, PK, MAPL, Komunat, organizatat ndërkombëtar e dhe vendore partnere	Në vazhdi mësi	Kosto Administrative,	
2.6 Organizimi i rregullt i takimeve ndërmjet Ministrisë të MPB-së me anëtarët e forumeve të sigurisë	Nr. takimeve	MPB	Komunat, Forumet e Sigurisë,	Në vazhdi mësi	4.200,	3 vite,

Objektivi Strategjik: 3. Koordinimi ndërinstitucional në të gjitha nivelet dhe në bashkëpunim me qytetarët;

3.1. Përdorimi i formave standarde për shkëmbim të informatave kthyesë në mes të forumeve të sigurisë dhe institucionet e tjera.	Numri i raporteve të pranuar sipas formave standarde	Forumet e Sigurisë	MPB, MAPL	Në vazhdi mësi	Kosto Administrative	
3.2. Organizimi i rregullt i Këshillit Ekzekutiv të EVSB-ve	Së paku një (1) në vit	EVSB	MPB, Komunitat, OJQ vendore dhe ndërkombëtare	Në vazhdi mësi	1.500,	Për 3 vite,
3.3. Organizimi i takimeve ndërmjet forumeve të sigurisë me komunitet qytetar	Nr. takimeve	Forumet e Sigurisë	Komunitat, MPB, MAPL	Sipas nevojës	Komunitat, Kosto Administrative,	
3.4. Organizimi i takimeve ndërmjet anëtarëve të forumeve të sigurisë dhe shoqërisë civile	Së paku 1 takim në vit	Forumet e Sigurisë	Komunitat, OJQ, MPB, PK, MAPL	vazhdi mësi	Kosto Administrative,	

për të trajtuar çështjet e sigurisë në bashkësi						
3.5. Organizimi i seminarit me komunitetin e biznesit për rolin e forumeve të sigurisë dhe mundësive të bashkëpunimit për çështjet e sigurisë	Seminari i realizuar	MPB	Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), Aleanca Kosovare e Biznesit (AKB),	Së paku njëherë në vit	Donacion,	
3.6. Ngritja e kapaciteteve dhe përfshirja e forumeve të sigurisë në identifikimin e sistemeve të paralajmërimit të hershëm me bazë në komunitet	8 trajnime dhe 8 punëtori të realizuara në 7 regjionet e Kosovës (8 komuna)	AME, Kryqi i Kuq i Kosovës dhe Save the Children International	MPB, MASHT, Komunat, Forumet e Sigurisë,	3 vite	5.400, Donacion,	Për 3 vite, Save the Children,
3.7. Organizimi i konferencës vjetore në mes të MPB-së dhe kryesuesve të	Konferenca e realizuar (se paku 1 në vit)	MPB	MAPL, Komunat, Partnerët Ndërkombëtar	Në vazhdi mësi	2.400, Donacion,	Për 2 vite MPB, OSBE 2017,

KKSB-së						
3.8. Pjesëmarrja në takimet rajonale (ndërshtetërore) për shkëmbimin e përvojave lidhur me fushën e sigurisë në bashkësi.	Nr. takimeve të realizuara	MPB	Partnerët Ndërkombëtar	Në vazhdi mësi	MPB, Donacion,	
3.9. Sigurimi i mbështetjes financiare nga MPB, me participim nga komuna për mbështetje të projekteve të forumeve të sigurisë për sigurinë në bashkësi	Fondi i siguruar	MPB	MAPL, Komunat, partnerët ndërkombëtar, OJQ,	Në vazhdi mësi	150.000 MPB , 75.000 Komuna, si dhe Donacion,	Për 3 vite,
3.10. Ndarja e mirënjohjeve për kontributin në aktivitetet e sigurisë në	Nr. i mirënjohjeve të ndara	MPB	Forumet e sigurisë, komunat	Në vazhdi mësi	Kosto administrative,	

bashkësi						
Objektivi Strategjik: 4. Vetëdijesimi i qytetarëve të Republikës së Kosovës për kërcënimet relevante të sigurisë në bashkësi;						
4.1. Identifikimi i kërcënimeve relevante të sigurisë dhe përparësia e tyre	Raporti për kërcënimet e identifikuar nga të gjitha KKSB	KKSB	forumet e sigurisë, PK,	K4, Në vazhdi mësi	Kosto administrative,	
4.2. Hartimi dhe zbatimi i planeve të veprimit për adresimin e kërcënimeve të identifikuar.	Nr. i planeve të hartuara nga KKSB,	KKSB	MPB, Forumet e sigurisë, PK,	K1- në vazhdi mësi	Kosto administrative,	
4.3. Zhvillimi i modelit nacional të Planit për Menaxhim të Fatkeqësive në Shkolla	Modeli i hartuar dhe i aprovuar nga bartësit e përgjegjësive	AME dhe Save the Children International	MPB, MASHT, Komunitat, Forumet e Sigurisë,	3 vite	5.240, Donacion,	Për 3 vite, Save the Children,
4.4. Zbatimi i aktiviteteve konkrete nga planet e veprimit	Nr. i aktiviteteve të realizuara	KKSB	Forumet e Sigurisë, PK	Në vazhdi mësi	Komunitat, Grante dhe Donacion,	

4.5. Krijimi i platformës "online" ku qytetarët kanë mundësi t'i adresojnë çështjet e tyre në fushën e sigurisë	Platforma e krijuar	MPB	MAPL, partnerët ndërkombëtar	2018 - 2023	MPB - IT dhe Donacion,	UNDP,
4.6. Pilotimi i Planit për Menaxhim të Fatkeqësive dhe mbështetja e Shkollave për krijimin e ekipeve për menaxhimin e emergjencave	15 institucione arsimore kanë krijuar planet, 15 institucione arsimore kanë themeluar ekipet për menaxhim të Emergjencave	AME, Kryqi i Kuq i Kosovës dhe Save the Children International	MPB, MASHT, Komunitat, Forumet e Sigurisë,	3 vite	100.000, Donacion,	Për 3 vite, Save the Children,
4.7. Organizimi i takimeve informuese për media në lidhje me Strategjinë për Siguri në Bashkësi	Nr. i takimeve informuese të realizuara	MPB-ZIP	MAPL, PK	K1 - 2018	Kosto administrative,	
4.8. Organizimi i takimeve të rregullta me përfaqësues të mediave lidhur me problemet e	Nr. takimeve të realizuara	Forumet e Sigurisë	MPB-ZIP, zyrat komunale për informim	Në vazhdimësi	Kosto administrative,	

sigurisë						
4.9. Sesione informative për rolin dhe përgjegjësitë e forumeve të sigurisë në institucionet para universitare dhe universitare	Numri i sesioneve të realizuara	MPB	MASHT, PK, Organizatat studentore	2018	Kosto administrative,	
4.10. Sensibilizimi i qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë e sjelljet e dhunshme përmes organizimit të ligjëratave në shkolla, debateve dhe kampeve	Numri i aktiviteteve të realizuara	Forumet e Sigurisë	MPB MASHT PK	Në vazhdi mësi	Kosto Administrative, Donacion,	

4.11. Organizimi i fushatës për vetëdijesimin e përdorimit të sigurt të fishekzjarrëve	Realizimi i fushatës	MPB	MASHT, Komunitat, Forumet e Sigurisë	K4-2017-2023	15.000, 23.966.11,	për 3 vite, Përdorimi dat. (26.12.2017-02.01.2018)
--	----------------------	-----	--------------------------------------	--------------	-----------------------	--

Objektivi Strategjik: 5. Avancimi i bazës ligjore lidhur me mekanizmat e sigurisë në bashkësi;

5.1. Themelimi i GP për vlerësimin dhe harmonizimin e zbraçësive ligjore si dhe nevojat e plotësimit ndryshimit të bazës ligjore	Raporti vlerësues	MPB	MAPL PK Forumet e sigurisë AKK	K1-2018	Kosto administrative,	
--	-------------------	-----	---	---------	-----------------------	--